



Prishtinë: 30.11.2012

Kodi i ZRRE-së: V\_483\_2012

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_851\_08\_2012

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreu IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_851\_08\_2012**; dhe
5. Ankesën e konsumatorit me datë 10.10.2012;

**Në mbledhjen e mbajtur më 30 nëntor 2012, nxori këtë:**

### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit B.P. (shifra në KEK: DPZ – 49752) nga Fshati Bellacërk, Komuna e Rahovecit ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_851\_08\_2012 i datës 29.08.2012.

### A r s y e t i m

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 04.07.2008 kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit me shifër DPR – 49752 dhe gjatë inspektimit kanë konstatuar se konsumatori ka bërë vet ndërrimin e njehsorit elektrik, si dhe punëtorët e autorizuar të KEK-ut e kanë udhëzuar konsumatorin që në afat prej 8 ditësh ta sjell njehsorin në KEK, në të kundërtën do të konsiderohet si shfrytëzim i paautorizuar i energjisë.

Departamenti i Faturimit në KEK me datë 25.07.2008 e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPZ08HP04392 në vlerë prej 2,945.89€. Pas kësaj ngarkese të bërë nga KEK-u konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike. Departamenti për Konsumator në KEK pas ankesës së bërë nga konsumatori ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit dhe ka refuzuar ankesën e tij. Konsumatori pas marrjes së përgjigjes nga ana e KEK-ut, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 29.08.2012 ka nxjerr një vendim duke **refuzuar** ankesën e konsumatorit dhe duke obliguar konsumatorin që të paguaj borxhin e ngarkuar nga KEK-u në faturën e rikthimit të humbjeve DPZ08HP04392 të datës 25.07.2008 në vlerë prej 2,945.89 €.



Pas marrjes së vendimit të DMK-së, më datë 10.10.2012 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, me të cilën ka kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_851\_08\_12 të datës 29.08.2012. Konsumatori në ankesë thekson se njehsorin elektrik e ka ndërruar pas presioneve të bëra nga punëtorët e KEK-ut, dhe se pas ndërrimit të njehsorit elektrik pa i llogaritur pasojat e ka hedhur njehsorin elektrik. Konsumatori në vazhdim të ankesës së tij ka theksuar se është i vetdijëshëm për shkeljet e bëra me rastin e ndërrimit të njehsorit pa lejen e KEK-ut, andaj edhe duke u bazuar në këtë pranon ndëshkimin, por për një muaj e jo për 12 muaj me vlerë 2945.89€.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 30.11.2012 ka shqyrtuar dhe analizuar dëshmitë e paraqitura nga konsumatori, përkatësisht kundërshtimet e theksuara në ankesë ndaj vendimit të DMK-së.

Bordi i ZRRE-së ka vërejtur sipas procesverbalit të KEK-ut nr. 0113393 të datës 04.07.2008 konsumatori ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik pa lejen a punëtorëve të autorizuar të KEK-ut. Sipas kësaj Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se konsumatori ka bërë shkelje të dispozitave të Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, përkatësisht nenit 4 pika j, të kësaj procedure, ku thuhet se ndërrimi i njehsorit në mënyrë të paautorizuar nënkupton shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, andaj konsumatori nuk ka pas të drejt ligjore të bëjë ndërrimin e njehsorit elektrik, por është dashtë të bëjë kërkesë në KEK për ndërrim, pasi që ndërrimi i njehsorit elektrik duhet të bëhet vetëm nga punëtorët e autorizuar të KEK-ut.

Sipas analizës së bërë të rrjedhës së shpenzimit të energjisë elektrike del se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike sipas viteve ka pësuar rënie të shpenzimit dhe atë deri në ndërrimin e vet njehsorit elektrik nga ana e konsumatorëve, ngase pas ndërrimit të njehsorit elektrik nga ana e konsumatorit mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike ka pësuar rritje në krahasim me shpenzimin e bërë me njehsorin e vjetër. Nga analiza e bërë shpenzimit të energjisë elektrike vërehet se mesatarja e shpenzimit të energjisë me njehsorin elektrik nr. 17696833 prej periudhës 10/2002 – 07/2008 ka qenë 272 kWh/muaj, ndërsa mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin elektrik nr. 4983070 prej periudhës 08/2008 – 06/2012 është 396 kWh/muaj.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe listat e leximit të KEK-ut, ku është vërejtur se lexuesi i KEK-ut në listat e leximit duke përfshirë periudhën nga 05 dhe 06/2007 ka evidentuar se njehsori elektrik është në rregull; për periudhën 09, 10, 11, 12/2007 si dhe periudhat kohore 01, 02 ,03 , 05/2008, lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se njehsorit elektrik duhet t'i bëhet kontroll, ndërsa blloibat distributive i ka në rregull; për periudhën kohore 06/2008, lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se njehsori elektrik është në rregull; për periudhën kohore 07/2008, është evidentuar se është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik;për periudhën kohore 09/2008 evidentohet se njehsori elektrik është në rregull. Sipas kësaj vërehet se njehsori elektrik i konsumatorit nr. 17696833 që nga periudha 09/2007 – 05/2008 ka evidentuar se njehsori elektrik nevojitet për kontrollim.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të gjitha proceseve të KEK-ut, dhe ankesës së konsumatorit konstaton se Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka vepruar drejt në vendimin e tij.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 30.11.2012 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. **ZRRE/DMK\_V\_851\_08\_2012**, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmime tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar